



СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

EU QENDRA E KUVENDIT

BE LAJME janar2018
EUQ-numër 30/2018



KRYESIA E REPUBLIKËS SË BULLGARISË ME KËSHILLIN E BASHKIMIT EVROPIAN



Bulgarian Presidency of the Council
of the European Union

<https://eu2018bg.bg/>

Republika e Bullgarisë nga 1 janar i vitit 2018 ka ndërmarrë kryesimin nga Estonia. Kryesimi me Këshillin e BE-së ndërron mes shteteve-anëtare të Bashkimit në çdo gjashtë muaj. Republika e Bullgarisë është pjesë e treshit Estoni-Bullgari-Austri dhe programi i saj është miratuar zyrtarisht më 20 qershor të vitit 2017 në Këshillin për punë të përgjithshme të BE-së. Tre vendet kanë arritur marrëveshje për programin e fokusuar në sigurinë, përforsimin e kufijve të jashtëm të BE-së, rritjen ekonomike dhe konkurrencën.

Republika e Bullgarisë me frymë pozitive do të synojë në drejtim të arritjes së rezultateve reale dhe të orientuara kah ardhmëria, duke përcjell parimet e llogaridhënies dhe realizimin e kryesisë që do të jetë e "hapur për qytetarët".

Prioritete të Kryesisë Bullgare me Këshillin e BE-së:

1. *Ardhmëri për Evropën dhe personat e ri—rritje ekonomike dhe kohezion social;*
2. *Perspektivë evropiane dhe lidhje me Ballkanin Perëndimor;*
3. *Siguri dhe stabilitet në Evropë të bashkuar dhe të fuqishme;*
4. *Ekonomi digjitale dhe shkathtësi të nevojshme për ardhmërinë e Evropës.*

Kryesia Bullgare do të punojë në drejtim të avancimit të mirëqenies për gjithë qytetarët e BE-së nëpërmjet promovimit të kohezionit, që krijon kushte për unitet dhe solidaritet, si dhe kohezion të plotë të shoqërisë evropiane. Kryesia Bullgare do të angazhohet për stimulim të shoqërisë qytetare proaktive dhe pjesëmarrjen politike të rinisë evropiane në ndërtimin e shoqërisë së sigurt, të bashkuar dhe paqësore me respektim të vlerave evropiane. Qëllimi do të jetë të mbahet niveli i investimeve evropiane në arsim dhe hulumtim, duke përfshirë edhe në lidhje me sigurimin e qasjes në arsim dhe zhvillim të shkathtësive në çfarëdo moshe, stimulim të shkathtësive digjitale, sipërmarrëse dhe kreative, sigurim të infrastrukturës së

përshtatshme për arsim, trajnim dhe hulumtim.

Prioritet kyç i kryesisë bullgare do të jetë politika e zgjerimit të BE-së, që vazhdon të jetë instrumenti më efektiv për të garantuar paqe, stabilitet dhe prosperitet në Ballkanin Perëndimor. Ambicie e Kryesisë Bullgare është të jetë Kryesim Ballkanik.

Kryesimi bullgar jep domethënie të madhe për thellimin e bashkëpunimit dhe zhvillimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore. Tema për lidhjen e Ballkanit Perëndimor është me rëndësi të posaçme — e ashtuquajtura "Agjendë për ndërlidhje" (transport, komunikime, energji, arsim, digjitale) me pikëpamjen se qëllimi i saj është të përmirësohen lidhjet në tregun e vetëm të BE-së.

Në kontekstin e përgjithshëm në luftën kundër terrorizmit, kryesia bullgare do të inkurajojë shfrytëzimin e të gjitha mundësive për avancimin e bashkëpunimit ndërmjet faktorëve kompetent për zbatimin e legjislacionit dhe shërbimeve të sigurisë si dhe këmbimin e informatave me agjencitë evropiane.

Kryesia do të punojë në mënjanimin e barrierave juridike për tregti tejkuftare dhe për progres të veçantë në të ballafaquarit me barrierat ekzistuese të cilat pengojnë vendosjen e tregtisë tejkuftare të shërbimeve dhe mallrave në BE.

Përmbajtje e lajmeve:

Kryesia e Republikës së Bullgarisë me Këshillin e Evropës 1

Aktivite të kundëruara në lidhje me çështjet evropiane 2-3

Në fokusin e Parlamentit Evropian 4-5

Valeta dhe Luvarden qendra të Kulturës evropiane për vitin 2018 6

Marrëveshje Elisejane e Re 6

Plan për Fond Monetar Evropian më të mirë 7

Hungaria dhe Polonia në mbrojtje të pozicioneve për buxhet më të madh të 8

Fuqizim i bashkëpunimit në fushën e vlerësimit të teknologjive të reja shëndetësore 9

Viti Evropian i Trashëgimisë Kulturore 2018 10

Dita Evropiane e energjetikës 11

BE kalendar/ shkurt2018 11

AKTIVITETE KUVENDORE NË LIDHJE ME ÇËSHTJET EVROPIANE



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, z. Talat Xhaferi, më 18 janar të vitit 2018 mbajti takim me Jens Stoltenberg, sekretari gjeneral i NATO-s, i cili ka qëndruar në vizitë zyrtare në Republikën e Maqedonisë.

Kryetari i Kuvendit në takim ka shprehur mirënjohje të madhe për mbështetjen e ofruar nga sekretari gjeneral i NATO-s dhe ka shprehur bindje se vetëm me dialog konstruktiv me fqinjët në lidhje me çështjet e kontestueshme dhe me angazhim aktiv të institucioneve dhe të gjitha subjekteve politike në përmbushjen e Planit 3-6-9, do të përfundohet “puna e pakryer” nga Sami i Bukureshtit të NATO-s në vitin 2008.

Kryetari Xhaferi e prezantoi agjendën e Kuvendit për planin për përmirësimin e rregullores ligjore në sektorin e sigurisë, me çka do të sigurohet mbikëqyrje cilësore dhe demokratike parlamentare. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s e nënvizoi përkrahjen e mëtutjeshme të NATO-s për plotësimin e agjendës ambicioze reformuese të Qeverisë së re, veçanërisht në planin për sundimin e të drejtës, fuqizimin e shoqërisë multietnike dhe parimet e Marrëveshjes së Ohrit, si dhe për mirëmbajtjen dhe respektimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore. Si hap pozitiv në këtë drejtim është ratifikimi i Marrëveshjes për marrëdhënie të mirë fqinjësore me Republikën e Bullgarisë, me çka hapet kapitull i ri dhe cilësor në kontekst rajonal.

Stoltenberg mbajti fjalim pranë deputetëve në seancën nr. 31 të Kuvendit.

DEKLARATË PËR PËRSHPEJTIMIN E PROCESVEVE REFORMUESE DHE INTEGRATIVE PËR ANËTARËSIM TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NË BASHKIMIN EVROPIAN DHE NATO



Me qëllim të konfirmimit të harmonizimit dhe përkushtimit mbipartiak në lidhje me përpjekjet e përbashkëta për realizimin e përcaktimit të shtetit tonë strategjik, anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe NATO, për çka ekziston pajtim nga ana e të gjithë faktorëve politik të përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Komisioni për çështje evropiane pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në mbledhjen e vet të parë më 28 qershor 2017 mori vendim për përpilimin e propozim-Deklaratës për përshpejtimin e proceseve reformuese dhe integrative për anëtarësim të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian dhe NATO. Propozimi i Deklaratës është miratuar në seancën e dytë të Komisionit të mbajtur më 14 korrik 2017 dhe i është dërguar kryetarit të Kuvendit të R. së Maqedonisë, z. Talat Xhaferi më 15 korrik të vitit 2017.

Deklarata është miratuar me 63 vota në Senacën nr. 27 të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të mbajtur në ditën 25 dhjetor 2017.

“Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e stimulon Qeverinë e Republikës së Maqedonisë me legjislacionin e Bashkimit, në pajtim me Programin nacional për miratimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian; angazhohet për pushtet të pavarur gjyqësor, transparencë dhe efikasitet të gjyqësorit; thekson rëndësinë e kohezionit social dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore, angazhohet për implementimin e plotë të Marrëveshjes kornizë të Ohrit në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë; i fton vendet anëtare të institucioneve të Bashkimit Evropian të japin mbështetje të fuqishme të proceseve integrative dhe reformave për aderim në BE dhe NATO; thërret Qeverinë në mënyrë të rregullt dhe gjithëpërfshirëse të raportojë dhe ta përfshijë Kuvendin në të gjitha aspektet e procesit aderues në BE dhe NATO”, janë pjesë e pikave përbërëse në Deklaratën e miratuar.

Në të njëjtën kohë deklarata paraqet obligim të ndërmarrë në suazat e Prioriteteve urgjente reformuese nga viti 2015, duke përfshirë edhe Rekomandimet e grupit të ekspertëve të lartë për çështje sistemore nga sundimi i të drejtës, të z. Pribe dhe obligimet nga Marrëveshja e Përzihinos.



AKTIVITETE KUVENDORE NË LIDHJE ME ÇËSHTJET EVROPIANE



Komisioni kuvendor për çështje evropiane, më 15 janar 2018 ka mbajtur mbledhjen e tetë, në të cilën ambasadori i Republikës së Bullgarisë, Ivan Velikov Petkov i prezantoi Programin dhe Prioritetet për punë të Kryesimit të Bullgarisë me Këshillimin e BE-së në gjysmën e parë të vitit 2018. Kryetari i komisionit, z. Artan Grubi theksoi se Republika e Maqedonisë pret më 12 korrik, në Samitin e NATO-s në Bruksel, ftesë për anëtarësim dhe fillim të negociatave për anëtarësimin tonë në BE, gjatë kryesimit të Bullgarisë me Këshillin e Evropës.

Ambasadori Velikov Petkov, në adresimin e tij informoi deputetët dhe mysafirët e pranishëm për moton e kryesimit me BE-në "Të bashkuar jemi më të fortë" si dhe për prioritetet, ndër të cilët e theksoi prioritetin e dytë të përkushtuar në perspektivën dhe lidhshmërinë evropiane të Ballkanit Perëndimor në BE. Ambasadori deklaroi se vendi i tij e mbështet Maqedoninë në përpjekjet e Qeverisë së kryeministrit Zaev, opozitës dhe sektorit qytetar për arritjen e çmimeve më të larta nacionale, anëtarësi në BE dhe NATO dhe kjo të ndodh gjatë periudhës kur me Këshillin Evropian kryeson pikërisht Bullgaria.

Kryetari i Komisionit për çështje evropiane, Artan Grubi, më 22 janar ka marrë pjesë në Konferencën e kryetarëve të Komisioneve për çështje evropiane të vendeve anëtare dhe shteteve candidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian në Sofje, Republika e Bullgarisë. Në konferencën, Grubi u adresua pranë deputetëve të parlamenteve nacionale të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe u përqendrua në perspektivën evropiane të Maqedonisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.

"Presim strategji pozitive, konkrete dhe afirmative nga z. Junker, rekomandim të pakushtëzuar dhe raport pozitiv, si dhe datë për negociatë, që e presim prej vitit 2005 me status kandidati dhe prej vitit 2009 me rekomandimin e parë për fillim të negociatave. Gjithashtu, duke pasur parasysh se shumica nga ju jeni shtete anëtare të NATO-s, presim përkrahjen tuaj edhe në samitin e Aleancës në korrik në Bruksel" - theksoi Grubi. Gjatës kohës së vizitës në Sofje, Grubi është takuar me kolegët e tij të rajonit dhe me kolegët e parlamenteve nacionale të vendeve anëtarë të BE-së.



Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, në përbërjen, Teuta Bilalli, Ejup Alimi, Agim Shaqiri, Petar Atanasov dhe Juliana Nikollova, më 23 dhe 24 janar të këtij viti ka mbajtur vizitë studimore dyditore në Parlamentin Evropian në Bruksel, Mbretëria e Belgjikës.

Tema kryesore të vizitës studimore ishin: roli i Parlamentit Evropian dhe vendi i vet në kornizën institucionale në Bashkimin Evropian, roli i Komisionit Evropian në procesin e zgjerimit, aktivitetet e Parlamentit Evropian në fushën e demokracisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Parlamenti Evropian dhe delegacionet për marrëdhënie me parlamentet e Ballkanit Perëndimor, rezolutat e përpiluara nga Parlamenti Evropian për Republikën e Maqedonisë, Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës. IPA fondet dhe tema tjera. Pjesëmarrësit në vizitën studimore kanë pasur më shumë takime bilaterale në të cilat kanë biseduar dhe këmbyer përvoja. Anëtarët e delegacioneve kanë marrë pjesë edhe në mbledhje të Komisionit për politikë të jashtme të PE në të cilën fjalim ka mbajtur ministria e punëve të jashtme të Republikës së Bullgarisë, Ekaterina Zaharieva, në kontekst të kryesimit të Bullgarisë me Këshillin e BE-së. Qëllimi i vizitës studimore ishte të ndahen përvojat e Republikës së Maqedonisë, Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës në procesin eurointegrativ, si dhe pritjet nga Strategjia e Komisionit Evropian për integrim të suksesshëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, që duhet të publikohet në fillim të muajit shkurt 2018.

NË FOKUS TË PARLAMENTIT EVROPIAN

**Sesion plenarë 15-18 janar 2018**

Në seancën plenare, eurodeputetët kanë deklaruar se është arritur përparim në negociatat për Bregzit. Në debatin me kryetarin e Këshillit Evropian, Donalld Tusk dhe kryetarin e Komisionit, Zhan-Kllod Junker, pas konkluzioneve prej samitit të BE-së nga 14-15 dhjetori, eurodeputetët kanë theksuar nevojën për formalizim të marrëveshjes për tërheqje sa më të shpejtë. Ata kanë thirrur qeverinë britaneze të paraqet qartë vizionin e saj për marrëdhëniet e ardhshme të vendit me BE-në. Disa prej deputetëve kanë bërë qartë të ditur se asnjë status jashtë BE-së nuk do të jetë asnjëherë i mjaftueshëm siç është anëtarësimi me të drejta të plotfuqishme në BE.

Eurodeputetët i kanë përshëndetur hapat konkret të cilat kohëve të fundit janë ndërmarrë për bashkëpunim më të madh me në mbrojtjen ndërmjet shteteve të BE-së, kanë theksuar nevojën për reforma në eurozonën dhe kanë apeluar për më tepër masa të BE-së për t'u përballur me sfidat e migracionit dhe papunësinë e të rinjve.

Në sesionin plenar deputetët kanë parashtruar amendament për ndaim të përdorimit të rrymës pulsuese elektrike për peshkim. Ligji i ri—që parashtrim azhurnim dhe kombinim të mbi 30 rregulloreve—do të sigurojë masa të përbashkëta për pajisjet dhe metodat për peshkim, madhësia minimale e peshkut që mund të kapen dhe të ndërpritet ose të kufizohet peshkimi në zona të caktuara ose në periudha të caktuara. Gjithashtu, mundëson të adaptohen masat e dedikuara për nevojat e çdo pellgu detar. Amendamenti me të cilin kërkohet krejtësisht të mënjanohet përdorimi i rrymës elektrike për peshkim është miratuar me 402 vota, 232 kundër dhe 40 të përmbajtur Parlamenti Evropian ka dhënë autorizim që anëtarët e Komitetit për peshkim të fillojnë biseda me Këshillin për formulimin përfundimtar të legjisllacionit.

Parlamenti Evropian është i gatshëm të fillojë biseda me ministrat për dy lidhje nga fusha e parandalimit të financimit të terrorizmit dhe krimit të organizuar, me qëllim të zvogëlohet shkalla e si dhe më lehtë të luftohet larja e parave dhe lehtësimi i ngrirjes tejkufitare dhe konfiskim të profiteve kriminele. Direktiva për parandalimin e larjes së parave do ta

përmirësojë zbatimin me përcaktimin e përkufizimeve të BE-së për vepra penale dhe dënime minimale. Eurodeputetët, propozojnë ndalesë për personat e gjykuar të kandidohen për funksion publik ose të kenë post të punonjësve shtetëror.

Rregullorja tejkufitare për konfiskim do të vendos afate të forta përfundimtare që vendet anëtare të veprojnë për kërkesa ndërkufitare për ngrirje ose konfiskim të mjeteve, duke u lënë më pak kohë kriminelëve t'i transferojnë. Procesi do të jetë i thjeshtësuar me qëllim të lehtësohet zbatimi i konfiskimit ndërkufitar, për shkak se ato nuk janë mjaft të shfrytëzuara sipas rregullave aktuale. Për momentin janë konfiskuar vetëm rreth 1,1% të të hyrave kriminele.

Eurodeputetët kanë përshëndetur synimin e kryesimit të Bullgarisë për t'u fokusuar në perspektivën e BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe ardhmërinë e të rinjve në Evropë.

Migracioni, lufta kundër korrupsionit, mbrojtja e mjedisit jetësor, sfidat për sundimin e të drejtës dhe drejtësia sociale janë theksuar si fusha ku nevojiten përpjekje plotësuese të përbashkëta. Diskutimi ka përfshirë buxhetin më shumë vjeçar të Bashkimit Evropian dhe është konstatuar se debati duhet të nis nga prioritetet e BE-së.

<http://www.europarl.europa.eu>

NË FOKUS TË PARLAMENTIT EVROPIAN

Kontrulli i eksportit në BE duhet të përhapet edhe në veglat për sajber-mbikëqyrjen për t'u shmangur cenimet e të drejtave të njeriut. Bashkimi Evropian për momentin i azhurnon rregullat për kontroll të eksportit të objekteve me përdorim të dyfishtë për të përcjell teknologjitë e reja dhe t'i parandalojë regjimet autoritare t'i spiunojnë qytetarët e tyre me ndihmën e produkteve evropiane. Rregullat e reja do të shtojnë vegla të reja për sajber-mbikëqyrjen e listës së objekteve që duhet të miratohen nga ana e autoriteteve shtetërore para se të eksportohen. Ato përfshijnë aparate për ndërhyrje në telefona celular, hakim të kompjuterëve, falsifikim të fjalëkalimeve ose identifikim të internet shfrytëzuesve, për shkak se objektet e tilla me përdorim të dyfishtë janë gjerësisht të përdorura për trysni civile, opozita politike dhe aktivistët nga mbarë bota.

Eurodeputetët dëshirojnë mbrojtje më të madhe për të drejtat e njeriut dhe të krijohet sistem i cili shpejtë mund të ballafaqohet me teknologjitë e reja. Sugjerimet kryesore të eurodeputetëve janë:

- mbrojtja e të drejtës për privatësi, të dhëna dhe liri e grumbullimit, me inkorporim të kriterëve dhe përkufizimeve të qarta në ligjin;
 - eksportuesit e produkteve të cilët nuk janë të përmendur në legjislacionin e ri, por të cilët mund të shfrytëzohen për shkeljen e të drejtave të njeriut, duhet të sigurohen që malli i tyre nuk do të bie në duart e gabuara, duke përcjell udhëzimet për "kujdes" të OECD-së;
 - Komisioni Evropian ka publikuar doracak para hyrjes në fuqi të rregullave të reja, për informim të bizneseve në BE;
 - rreziqet e reja dhe teknologjitë duhet shpejtë të instalohen në ligjin,
 - duke krijuar kushte të barabarta ndërmjet vendeve-anëtare, p.sh. inkorporim të dënimeve të ngjashme për mos harmonizim, bashkë me transparencë më të madhe të vendimeve për kontroll të eksportit nga autoritetet nacionale; dhe
 - mënjanim të teknologjive për enkriptim nga lista e produkteve për sajber-mbikëqyrje, për shkak se ato janë vitale për mbrojtjen e mbrojtësve për të drejtat e njeriut.
- Rregullat e reja janë përkrahur me 571 vota pro, 29 kundër dhe 29 të përmbajtur.

Parlamenti Evropian ka përzgjedhur dy anëtarë të ri Gjykatën Evropian të revizorëve. Kandidati irlandez, Toni Xhejms Marfi, i dominuar nga qeveria e Irlandës pas procesit të zgjedhjes publike, ka më shumë se 30 vjet

përvojë në sferën e revidizionit në nivel nacional dhe evropian. Për momentin është drejtor në ECA. Kandidatja e Suedisë, Eva Lindstrom, aktualisht sekretare shtetërore e ministrit për ndërmarrje dhe rinovime, ka qenë Kryerevi zor prej vitit 2003 deri në vitin 2010. Ajo e kryen funksionin zëvendës kryetare e këshillit suedez për politikë fiskale.

Parlamenti Evropian ka miratuar propozimet e Komisionit për qëllime obliguese në nivel të BE-së në përmirësimin e efikasitetit energjetik për 35%, pjesëmarrje të energjisë në burime të rigjenerueshme në bruto konsumin final të energjisë të jetë në nivel minimal prej 35% dhe pjesëmarrje prej 12% të energjisë prej burimeve të rigjenerueshme në transport deri në vitin 2030. Për t'u plotësuar këto qëllime të përgjithshme, vendet-anëtare të BE-së kërkohet të vendosin qëllimet e tyre nacionale, të mbikëqyrjen dhe të realizohen në pajtim me draft-ligjin për menaxhim me unionin energjetik. Negociatat me Këshillin mund të fillojnë menjëherë, duke pasur parasysh që ka përmirësuar qasjet e përgjithshme për efikasitet energjetik më 26 qershor dhe për burimet e rigjenerueshme të energjisë dhe menaxhim me unionin energjetik në 18 dhjetor.

Eurodeputetët kanë vendosur fëmijët në nivelin më të lartë të kujdesit me miratimin e propozimet të tyre për ndryshim të ligjeve të BE-së për zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare për divorc. Mendimi i Parlamentit Evropian është miratuar me 562 vota pro, 16 kundër dhe 43 abstenime. Mendimi do të parashtrohet në Këshill, që është përgjegjës për miratimin e vendimit përfundimtar.

<http://www.europarl.europa.eu/portal/en>



<http://www.europarl>

VALETA DHE LUVARDEN, QENDRAT E KULTURËS EVROPIANE PËR VITIN 2018



<http://europa.eu>

Titullin “Qendër e kulturës evropiane” në vitin 2018 do ta marrin qytetet Luvarden në Holandë dhe Valeta në Maltë. Zgjedhja për qendrën evropiane të kulturës paraqet mundësi për qytetet të krijojnë imazhin e tyre, të shënohen në kartën botërore, të tërheqin më tepër turistë dhe t'i shqyrtojnë mundësitë për zhvillim nëpërmjet kulturës.

Hapja solemne e programit për “Qendrën kulturore Evropiane” në Valetë filloi më 14 janar, e inspiruar prej festivalit tradicional maltez. Komisari evropian për arsim, kulturë, të rinj dhe sport, Tibor Navraçiq, mori pjesë në hapjen solemne më 20 janar.

Në Luvarden, hapja e programit filloi më 26 dhe 27 janar me instalime artistike dhe performanse nga artist profesional dhe amator nëpër qytet, ndërkaq muzetë e rajonit Frislandi kanë hapur dyert e tyre për vizitorët. Nën kryetari i parë i Komisionit Evropian, Frans Timermans ka marrë pjesë në hapjen zyrtare më 27 janar. “Qendra evropiane e kulturës u ndihmon komuniteteve të gjenerojnë efekte afatgjata nëpërmjet kulturës për qytetet, qytetarët dhe ekonominë”, theksoi Timermans në fjalimin e tij të rastit.

Dy qytetet kanë përfshirë projekte të shumta për promovimin e trashëgimisë kulturore në programet e qendrës Evropiane të kulturës,

me çka kanë kontribuar për theksimin e rolit në kulturë në krijimin e identitetit evropian, ka publikuar Komisioni Evropian.

Qendra evropiane e kulturës është themeluar në vitin 1985 me iniciativë të ministres së atëhershme të kulturës Melina Merkuri. Qytetet përzgjedhen në bazë të programeve kulturore të cilat kanë dimension evropian, që stimulojnë angazhimin e qytetarëve dhe kontribuojnë për zhvillimin afatgjatë të qytetit dhe zonës së rrethinës.

Më vitin 2017, qendrat evropian të kulturës ishin Arhus në Danimarkë dhe Pafos në Qipro.

Qendër evropian e kulturës në vitin 2019 do të jetë Plllovdiv në Bullgari dhe Matera në Itali, ndërkaq në vitin 2020 në Rijekë (Kroaci) dhe Gallvej (Irlandë), ndërsa në vitin 2021 Timisoara (Romani), Elefsina (Greqi) dhe Novi Sad (Serbi).

MARRËVESHJE E RE ELISIJANE



Në 55 vjetorin e marrëveshjes nga viti 1963, Kuvendi Nacional i Francës dhe Bundestagu i Gjermanisë njëkohësisht kanë miratuar rezolutë me të cilën thirret në fuqizim të marrëdhënieve frënge-gjermane.

Bashkëpunim i përforcuar është fjalë kryciale në takimet e organizuara me rastin e 55 vjetorit nga nënshkrimi i Marrëveshjes Elisijane. E nënshkruar më vitin 1963, marrëveshja e shënon pajtimin e dy vendeve dhe fillimin e bashkëpunimit intensiv.

Pas takimit të Kancelares Gjermane Angela Merkel dhe Presidentit francez Emanuel Makron, deputetët francez dhe gjerman është paraparë të bisedojnë për bashkëpunim “të përmirësuar” mes dy vendeve, në rezolutën që më 22 janar të këtij viti është votuar nga ana e dy asambleve parlamentare.

Kryetarët e Kuvendit Nacional dhe të Bundestagut, me ftesë të kolegëve nga institucionet e tyre, sërish kanë konfirmuar validitetin e marrëdhënieve franceze-gjermane. “Franca dhe Gjermania nuk janë

vetëm binom: dy vendet tona përbëjnë familje!”, deklaroi kryetari i Kuvendit Nacional Fransoa de Rugi, ndërsa kryetari i Bundestagut, Volfgang Shaul ka thirrur në “zhvillim të mëtutjeshëm të marrëdhënieve tona të afërta”.

Pas takimit më 19 janar, Angela Merkel dhe Emanuel Makron ka publikuar deklaratë të përbashkët në të cilën gjithashtu përmendet “të elaborohet gjatë vitit Marrëveshje Elisijane e re”, për “konsolidim dhe ripërtëritje” të bashkëpunimit francez-gjerman.

<http://www.france24.com>

PLAN PËR FOND MONETAR EVROPIAN MË TË MIRË

Komisioni Evropian ka propozuar zhvillim të mëtejshëm të transerit të Mekanizmit Evropian për stabilitet (MES) në Fond Monetar Evropian (FME).

Fillimisht Këshilli Evropian duhet të jetë i aftësuar për miratim ose refuzim të programeve. Për hap të mëtejshëm të propozohen më tepër instrumente dhe mjete të FME-së për përkrahje të shteteve dhe bankave të ndikuara nga krizat. Si hap i tretë, rregullisht të parashtroj raporte për aktivitetet e realizuara në Parlamentin Evropian dhe parlamentet nacionale me qëllim të arrihet kontroll më i madh demokratik.

Ekspert të caktuar konsiderojnë se koncepti i reformave të Komisioni Evropian nuk është i baraspeshuar për shkak se është rreptësisht i bazuar në programe për shpëtim, por nuk kontribuon për parandalimin e krizave.

Paniku i pabazë i tregjeve financiare mund të jetë kundërproduktiv, por mbase investuesit nuk do të jenë të inkurajuar t'u japin shteteve qasje të lehtë në kredi kur janë të vetëdijshëm se obliguesit tatimor të vendeve tjera do t'i përmbushin edhe shpenzimet për ngarkim të tepruar me borxh. Parapëlqehet kontroll demokratik dhe pjesëmarrje në institucionet evropiane, por e njëjta duhet të mbetet e aftë të reagojë shpejtë ndaj krizave. Kontrolli në fund duhet të mbetet me ata të cilët janë përgjegjës për financimin e politikës për shpëtim. Deri më sot kjo donë të thotë parlamente nacionale, kurse jo institucione evropiane..

Nën kryesi të Zhan-Kllod Junker, Komisioni Evropian ka shprehur qëllimin që ka për të vepruar në mënyrë më politike në të ardhmen. Kjo do të kishte minimizuar rolin e vet rojtar neutral i marrëveshjeve evropiane, që paraqet aargument për kufizim të ndikimit të Komisionit për FME-në të ardhshëm.

Me qëllim të zmadhohet aftësia e FME-së të ndërmer aksion dhe ta përforcojë kredibilitetin e vet në rast të krizës, duhet të ndërmerren masa për parandalimin e krizave dhe mbrojtjen e obliguesve tatimor nga përgjegjësia për borxhet e vendeve tjera ose bankat josolvente të cilat mund të

ndahen në disa faza:

- në fazën e parë mbikëqyrja e rregullave për ngarkim me borxh duhet të transferohet nga Komisioni Evropian i FME-së për t'u depolitizuar procesi. Çështja për atë nëse vendet kanë shkelur rregullat për ngarkim me borxh është çështje e fakteve të shëndosha. Kurse jo vlerësim politik.

- në fazën e dytë FME duhet të bisedojë për rreziqet e reja për stabilitetin financiar gjatë konsultimeve të rregullta me vendet-anëtare në lidhje me euron dhe të publikojë protokolle për këto biseda, sipas shembullit të FMN-së me konsultim të nenit IV.

- në fazën e tretë, investitorët duhet të jenë të përgjegjshëm për shtetet dhe bankat me nivel të lartë të ngarkimit me borxh. Kjo donë të thotë se bankat duhet të kenë më tepër kapital aksionar dhe më pak obligacione shtetërore, përndryshe mund të shkaktojë krizë bankare. Kombinimi nga mbulimi i kapitalit dhe dispozitat për diversifikim mund t'i stimulojnë bankat të arrijnë vijën..

Formimi i FME-së që prej së afërmi e harmonizon përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen, duke kombinuar përgatitje efikase me masa më të mira mbrojtëse në rast të krizës, do të jetë në ndihmë të Eurozonës.

<https://www.euractiv.com>



HUNGARIA DHE POLONIA NË MBROJTJE TË POZICIONEVE PËR BUXHET MË TË MADH EVROPIAN



Qeveritë e Hungarisë dhe Polonisë më 8 mars kanë shprehur gatishmëri të kontribuojnë me mjete më të mëdha financiare në Kornizën Shumëvjeçare Financiare (KSHF) të Bashkimit Evropian pasi Britania e Madhe të del nga BE-ja në vitin 2019.

Duke i theksuar kritikën e përmendura në të kaluarën, në drejtim të institucioneve të BE-së dhe politikave të përbashkëta, posaçërisht migracioni, të dy vendet e kanë ftuar Komisionin Evropian të përpilojë draft-propozim për KSHF të ardhshme që duhet të jetë “më e guximshme” nga e fundit për periudhën 2014-2020.

Komisari për buxhet të BE-së, Ginter Ottinger, për EURACTIV.com ka deklaruar se shuma prej 60 miliard euro është e qëndrueshme për shkak se çmimi i Bregzit “nuk është totalisht i gabuar”. Këtë deklaratë e dha vetëm disa ditë para se Britania ta fuqizojë nenin 50, me të cilin ka iniciuar procesin juridik për braktisje të bllokut.

Sekretari shtetëror për çështje evropiane të Polonisë, Konrad Shimanski, deklaroi se Polonia e mbështet qëllimin e Komisionit të propozojë në FMN, BPV më të lartë për 1% të BE-së.

Të dy vendet kanë dërguar mesazhe paralajmëruese kundër atyre që janë për zvogëlimin e shpenzimeve në politikën për kohezion, një prej zarfeve më të mëdha me 350 miliard euro, që përfshin 1/3 e FNF-së.

Shimanski deklaroi se planifikon t'i bën zvogëlimet “tepër të thjeshta”, duke përkujtuar se politika për kohezion “ka ardhmëri të ndritshme”, duke pasur parasysh se është e hapur për reforma dhe dëshmon vlerën e saj plotësuese.

Kolegjiumi i komisarëve ka mbajtur diskutimin e parë për këtë temë më 10 janar, derisa draft-propozimi për Kornizën Shumëvjeçare Financiare do të publikohet në maj. Komisioni pret që vende-anëtare dhe Parlamenti Evropian të arrijnë marrëveshje deri pranverë të vitit të ardhshëm, para zgjedhjeve të ardhshme evropiane.

Të përballur me njëjën e zmadhuar në buxhetin e BE-së pas vitit 2020, të shkaktuar nga Bregzit dhe shpenzimet e zmadhuara për sigurinë, Komisioni është duke menduar për reduktimin e financimit të bujqve, kushtëzim të shpenzimeve në

zbatimin e sundimit të së drejtës në vendet-anëtare dhe mënjanimin e lëshimeve pasi Britania e Madhe të braktis Bashkimin Evropian.

Negociatat do të bëhen një prej betejave kryesore politike gjatë 18 muajve të ardhshëm. Zvogëlimet potenciale të kohezionit dhe politikës së përbashkët bujqësore (PPB), pamundësia të kritikohet pozita e Francës dhe rritja e konsiderueshme e shumës së përgjithshme për të ballafaquar me prioritetet e reja dhe mbulimin e mungesës së Bregzit, në mënyrë plotësuese do t'i ndërlikojnë bisedat.

Kryetari i Komisionit, Zhan-Klod Juncker, parasheh propozim ambicioz për buxhetin e ardhshëm afatgjatë. Juncker ka shprehur kundërshtimin e tij për zvogëlimin “drastik” të kohezionit ose të PPB dhe ka apeluar për rritje të mjeteve financiare për “Evropë ashtu siç e dëshirojmë”.

Megjithëse nuk mund të verifikojë pozitën gjermane në negociatat, ai premtoi se Evropa do të jetë qendra e kësaj marrëveshjeje së koalicionit.

“Grupi Monti” ka propozuar mënyra të reja të buxhetimit për periudhën prej vitit 2020, duke e sfiduar parimin e “kthimit të drejtë” dhe shqyrtimin e mundësive për braktisje të zbritjes për Britaninë e Madhe sipas draft-raportit të EURACTIV.com.

Shumica e ekspertëve pajtohen së pari të përkufizohen prioritetet për Kornizën Shumëvjeçare Financiare të ardhshme para se të përcaktohen mjete të përshtatshme për realizimin e qëllimeve.

Ndërmjetësuesit e Bashkimit Evropian kanë demonstruar unitet në takimin në të cilin është biseduar për shkëputjen e Britanisë, në përpjekje për t'i parandaluar dallimet të cilat mund të ishin paraqitur në fazën e mëtejshme të bisedave.

<https://www.euractiv.com>

FUQIZIM I BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E TEKNOLOGJIVE SHËNDETËSORE

Komisioni Evropian më 31 janar të vitit 2018 ka miratuar propozimin për fuqizim të bashkëpunimit ndërmjet vendeve-anëtare të BE-së në fushën e vlerësimit të teknologjive shëndetësore.

Propozimi vjen pas më tepër se 20 viteve bashkëpunim vullnetar në këtë sferë. Palët e tanguara dhe qytetarët të cilët janë përgjigjur në konsultimet publike të Komisionit kanë dhënë përkrahje të madhe, me ç'rast pothuaj të gjithë (98%) kanë konfirmuar dobinë e NTA-së dhe 87% janë pajtuar se bashkëpunimi i BE-së për NTA-në duhet të vazhdojë edhe pas vitit 2020.

Transparenca më e madhe i stimulon pacientët të sigurojnë qasje në informatat për vlerën e shtuar klinike të teknologjisë së re dhe të kenë benefit nga e njëjta. Veglat efektive dhe rinovuese shëndetësore mund të kenë më tepër vlerësime, më shpejtë t'u ofrohen pacientëve, që për autoritetet nacionale donë të thotë mundësi për formulim të politikave për sistemet e tyre shëndetësore në bazë të provave më valide.

“Fuqizimi i bashkëpunimit në vlerësimin e teknologjisë shëndetësore në nivel të BE-së i fuqizon inovimet dhe avancen konkurrencën e industrisë mjekësore. Sektori shëndetësor është pjesë thelbësore e ekonomisë tonë, i njëjtë përfshin 10% të GDP-së së BE-së. Propozojmë kornizë rregullatore e cila do t'u mundësojë beneficione pacientëve njëkohësisht duke inkurajuar rinovimet, duke asistuar në ndërmarrjen e rinovimeve të cilësisë së lartë të medtechnikës dhe përmirësim të qëndrueshmërisë së sistemeve shëndetësore nëpër BE“, theksoi zëvendës kryetari i Komisionit, Jirki Katainen.

Komisari për shëndetësi dhe siguri në ushqim, Vitenis Andriukatis, plotësoi: “Sot, Komisioni ka lëshuar rrotat në lëvizje për cilësi më të lartë, mbrojtje inovative shëndetësore në dobi të pacientëve, veçanërisht ata me nevoja të paplotësuara mjekësore. Gjithashtu, pres që kjo iniciativë të rezultojë me shfrytëzim më efikas të shfrytëzimit të resurseve nga ana e vendeve-anëtare nëpërmjet unifikimit të resurseve dhe ekspertizës së zhvilluar,

me çka do të shmangët dublimi gjatë vlerësimit të produkteve identike”.

Rregullorja e propozuar për vlerësimin e teknologjive shëndetësore (NTA) përfshin ilaçe të reja dhe mjete të caktuara të reja, dike siguruar bazë për bashkëpunim permanent dhe të qëndrueshëm në nivel të BE-së për vlerësime të përbashkëta klinike në këto sfera. Vendet-anëtare do të mund të shfrytëzojnë NTA vegla të përbashkëta, metodologji dhe procedura nëpër BE, duke punuar bashkërisht në fusha primare:

- për vlerësime të përbashkëta klinike të fokusuar në teknologjitë më rinovuese shëndetësore me ndikim potencial për pacientët;
- për konsultime të përbashkëta shkencore me të cilat programuesit mund të kërkojnë këshillë nga organet e NTA-së;
- për identifikimin e teknologjive të reja shëndetësore për detektim të hershëm, teknologji premtuese;
- për bashkëpunim të vazhdueshëm vullnetar në fusha tjera.

Vendet-anëtare të BE-së në mënyrë individuale do të jenë përgjegjës për vlerësimin e aspekteve jo-klinike (si për shembull, ekonomike, sociale, etike) të teknologjive shëndetësore dhe miratimin e vendimeve për çmimet dhe kompensimet.

Propozimi edhe më tej do të shqyrtohet në Parlamentin Evropian dhe Këshillin e ministrave. Pritet që aplikimi i të njëjtit të fillojë pas 3 viteve nga miratimi dhe hyrja në fuqi. Pas datës së aplikimit, parashihet edhe periudhë trevjeçare për t'u mundësuar qasje etapore e vendeve-anëtare në adaptimin e sistemit të ri.

<https://www.euractiv.com>



VITI EVROPIAN I TRASHËGIMISË KULTURORE 2018



<https://europa.eu/cultural-heritage>

Me **Vendim** të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE-së, viti 2018 është shpallur për Viti Evropian i trashëgimisë kulturore.

Qëllimi i kësaj iniciative Evropiane është të promovojë rëndësinë e Trashëgimisë Kulturore Evropiane dhe ta ngrit vetëdijen për historinë dhe vlerat e përbashkëta evropiane.

Me sloganin "*Trashëgimia jonë: aty ku e kaluara takon të ardhmen*", nënvizohet përpjekja për të kuptuar më mirë të kaluarën nëpërmjet trashëgimisë kulturore, që njëkohësisht mundëson edhe dritare kah e ardhmja.

Viti Evropian për trashëgiminë kulturore do të theksojë vlerën e trashëgimisë kulturore për shoqërinë, kontributin e vet në ekonominë, rëndësinë e vet për marrëdhëniet të BE-së me pjesën tjetër të botës (diplomaci kulturor) dhe rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore për gjeneratat e ardhshme. Viti Evropian i trashëgimisë kulturore përfshin disa tema kryesore:

Përfshirje

Trashëgimi e ndarë:

përafrim të trashëgimisë kulturore, historisë dhe vlerave të përbashkëta tek qytetarët;

Trashëgimi kulturore në shkollë: zbulim të pasurive në Evropë nga mosha e hershme;

Rinia për trashëgiminë kulturore: angazhim i gjeneratës së re.

Qëndrueshmëri

Trashëgimia kulturore në tranzicion: pikëpamje e re ndaj lokaliteteve industriale, fetare dhe ushtarake;

Turizëm dhe trashëgimi: turizëm serioz dhe i qëndrueshëm në lidhje me trashëgiminë kulturore.

Ruajtje

Ruajtje e trashëgimisë:

zhvillim të standardeve për intervenime cilësore në mjedisin historik dhe të lokaliteteve;

Trashëgimi kulturore në rrezik: luftë kundër tregtisë ilegale me të mira kulturore dhe menaxhim të rreziqeve.

Inovime

Shkathësi për trashëgimi kulturore: përforsim të edukimit dhe trajnimeve për profesionet tradicionale dhe të reja;

Trashëgimi kulturore për të gjithë: stimulim të pjesëmarrjes dhe rinovimeve sociale;

Shkenca për trashëgiminë: shfrytëzim të hulumtimeve, rinovimeve, shkencës

dhe teknologjive për konservim më cilësor dhe prezantim të trashëgimisë kulturore.

Nëpërmjet këtyre temave, në vendet-anëtare të BE-së në vitin 2018 do të organizohen shumë ngjarje dhe projekt në nivel evropian, nacional, rajonal dhe lokal, të fokusuar në përfshirjen e opinionit më të gjerë, veçanërisht fëmijët dhe të rinjtë, të cilët do të ndihmojnë në avancimin e njohurisë së tyre për trashëgiminë kulturore, por edhe përkatësinë në familjen më të gjerë evropiane. Ky vit do të hap edhe mundësi për debat dhe rritjen e cilësisë së masave për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Edhe pse **Republika e Maqedonisë** nuk është anëtare e BE-së dhe nuk ka për obligim të zbatojë vendimin e institucioneve evropiane për zbatimin e këtij manifestimi mbarëvjetor, prapëseprapë Drejtoria për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ka identifikuar rëndësinë e temave të paraqitura për këtë vit, të cilat janë të përafërta edhe me përpjekjet e saj.

Në hapësirat e BE Info Qendrës në Delegacionin e Bashkimit Evropian, është prezantuar dhe filluar programi vjetor për shënimin e Vitit Evropian për trashëgimi kulturore 2018 me moton "Trashëgimia jonë—Vlerë evropiane", të përgatitur nga Drejtoria për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Gjatë vitit 2018 në Republikën e Maqedonisë do të realizohen ngjarje, konferenca, debate ekspertësh, promovime me të cilat do të theksohet simbioza ndërmjet vlerave evropiane dhe kulturës maqedonase.

DITA EVROPIANE E ENERGJETIKËS

Më 27 tetor të vitit 2017, Komisioni Evropian ka prezantuar programin e vet më të ri të punës për programin e vet kalimtar hulumtues dhe rinovues “Horizont 2020”, që është dedikuar për energji të pastër në vlerë prej 2,2 miliard euro.

Në suaza të Ditëve energjetike të BE-së, Direktorati i Përgjithshëm për energjetikë të Komisionit Evropian do të mbaj punëtori “Ardhmëria e energjisë së pastër të BE-së: nga zhvillimi i teknologjisë deri në integrim sistemor” që është iniciuar në Marekesh.

Komisioni do t'i prezantojë prioritetet e BE-së për përshtetjet të rinovimeve për energji të pastër, mundësitë më të reja për financim për periudhën 2018-2020. Do të mbahen debate për mundësitë për bashkëpunim ndërkombëtar me vende tjera me qëllim të rritjes së opsioneve në dispozicion për energji të pastër, si dhe bashkëpunim të përbashkët me organizatat udhëheqëse hulumtuese dhe kompanitë për të avancuar konkurrencën globale të burimeve të rigjenerueshme të energjisë.

Së bashku me Rrjetin për teknologji për energji të pastër të EU-GCC, punëtorja do të jetë vend i takimeve për institucionet evropiane hulumtuese dhe kompanitë rinovuese, të cilat do t'i këmbëjnë teknologjitë inovative, zgjidhje për energji të rigjenerueshme për konsumatorët si dhe zgjidhje të reja nëpërmjet digjitalizimit të sistemit energjetik.

Dita evropiane e energjetikës është pjesë e

programit kryesor të edicionit të dhjetë të Samitit botëror për energjinë e të ardhmes (WFES) 2018. Samiti numëron më tepër se 600 furnizues teknologjik, rinovues, prodhues, prezantime të zgjidhjeve më të reja në sektorin.

Përshtetjet i tranzicionit ndaj ekonomisë me karbon të ulët është sfidë globale dhe prioritet crucial i BE-së.

Për tu përgjigjur ndaj kësaj sfide, programi më i madh transnacional për hulumtim dhe inovime të BE-së “Horizont 2020” përshin fonde dhe instrumente të dedikuara për energji të pastër.

Bashkimi Evropian i cakton kornizat e reja politike për tranzicion në energji të pastër në pajtim me qëllimet për vitin 2020 dhe 2030, duke përfshirë edhe iniciativat për përkrahjen për synimin e BE-së të bëhet lider global në burimet e rigjenerueshme të energjisë.

<http://www.euenergyday.eu>



BE KALENDAR/ shkurt2018

1. Seancë Plenare e Parlamentit Evropian, 05-08/02/2018, Strazbur;
2. Debat publik i dedikuar për gratë me aftësi të veçanta në BE: gjendje dhe hap përpara, 09/02/2018, Bruksel, Belgjikë;
3. Shoqëri civile në BE: skenare të ardhshme për vitin 2030, 15/02/2018, Bruksel, Belgjikë.
4. Këshilli për punë të jashtme të BE-së, 26/02/2018, Bruksel, Belgjikë.

European Union Newsroom

europa.eu

EUROPA > Newsroom > Calendar

Home Highlights Press releases Calendar Audiovisual Press contacts Press facilities About the EU

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic
Choose a topic

By organiser
Choose an organiser

By type
Choose a type

BY MONTH

February

Sun	Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28			



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

BE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 tetor nr. 10, Shkup, 1000

Telefoni: +389 2 3 11 22 55 lokali 414 dhe 289

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

www.sobranie.mk

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë është zbatuar IPA Projekt për “Ndhmë teknike për Parlamentin”, në periudhën e muajit janar të vitit 2011-2012, qëllimi i përgjithshëm i të cilit ishte fuqizim i kapacitetit institucional të Kuvendit dhe me atë avancim i transparencës dhe përgjegjësisë së vet para qytetarëve.

Në kuadër të IPA projektit, është siguruar ndihmë financiare dhe profesionale për themelim të BE qendrës në Kuvend.

Qëllimi i formimit të BE qendrës është që deputetëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe Shërbimit të Kuvendit t’u sigurohet qasje më e mirë në informatat lidhur me BE çështjet.

BE qendra në formë organizative është në suazat e Sektorit për përkrahjen e Këshillit Nacional për eurointegritime.

BE qendra ka në dispozicion bibliotekë me libra dhe botime prej sferave të ndryshme të politikave evropiane.

